



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DURRËS**

Nr. 699 Prot.

Durrës, më 18.3.2022

SHPALLJE II

**E VENDIT TË LIRË PËR DREJTOR TË INSTITUCIONIT PUBLIK TË ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR (IPAP)**

Drejtorja Rajonale e Arsimit Parauniversitar Durrës , në zbatim të Ligjit 69/2012 “Për arsimin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM nr.99, datë 27.02.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar”, Udhëzimit nr.2, datë 28.01.2020 “Për procedurat e emërimit, uljes në detyrë, pezullimit dhe të shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar” i ndryshuar, shpall vendin e lirë të drejtorit të institucionet arsimore publik të arsimit parauniversitar IPAP bashkelidhur shpalljes:

Kriteret që duhet të plotësojë kandidati për të aplikuar për vendin e lirë për drejtor të IPAP:

- a) të ketë fituar diplomë të ciklit të dytë në fushën e edukimit ose diplomë të njëvlershme me të, sipas përcaktimeve të ligjit 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”;
- b) të ketë të paktën kategorinë “Mësues i kualifikuar”, me vlerësimin jo më pak se “ Mirë” , në kualifikimin e fundit.
- c) të mos ketë masa disiplinore në fuqi ndaj tij;
- d) Të jetë certifikuar nga Shkolla e Drejtorëve pas përfundimit me sukses të trajnimit të detyrueshm përgatitor për drejtimin e institucionit arsimor parauniversitar ose të jetë pranuar për të kryer atë.
- e) **Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit:**
 - 1. Dokumentacioni i aplikimit për pozicionin e drejtorit në IPAP përmban:



- a) jetëshkrimin dhe kopjet e njësuara me origjinalin të dokumenteve që dëshmojnë pohimet në të (sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi);
- b) kopjen e njësuar me origjinalin të librezës së punës;
- c) kopjen e dokumentit të identitetit (ID);
- d) tabelën me të dhënat për aplikantin (sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 4, bashkëlidhur këtij udhëzimi);
- e) certifikatën e drejtuesit të IPAP ose vërtetimin nga shkolla e Drejtorëve që është pranuar për të kryer trajnimin e detyrueshëm përgatitor.
- f) vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore (sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 2, bashkëlidhur këtij udhëzimi);
- g) vërtetim nga institucioni ku punon, që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- h) deklaratën e konfliktit të interesit me punonjësit arsimorë të IPAP (bashkëshort/bashkëshorte, prind, vëlla/motër, fëmijë në moshë madhore, prindër të bashkëshortit/bashkëshortes), sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 3, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

Drejtori aktual i IPAP ose zëvendësuesi i tij vë në dispozicion të secilit aplikant një kopje të dokumenteve të mëposhtme:

- a) planin afatmesëm të shkollës;
- b) planin vjetor të shkollës të vitit paraardhës;
- c) raportin vjetor të shkollës të vitit paraardhës

Dokumentacioni i aplikimit, i përcaktuar në pikën 2 ,të shkronjës B, dorëzohet nëpërmjet shërbimit postar në ZVAP-në përkatëse jo më vonë se data **05.04.2022**.

1. Data e shpalljes së rezultateve të verifikimit paraprak të dokumentacionit.

Rezultatet e verifikimit paraprak të dokumentacionit do të shpallen jo më vonë se data **08.04.2022**. Aplikantët me mungesa në dokumentacion do të njoftohen nëpërmjet e-mailit për plotësimin e dokumentacionit brenda 3 ditë pune nga data e njoftimit të verifikimit paraprak.

2. Brenda datës **12.04.2022**, bëhet shqyrtimi paraprak dhe njoftohet me shkrim /email aplikantët me mungesa ne dokumentacion, sipas shtojcave nr.1 dhe nr.4. bashkelidhur udhezimit ne fjale, duke caktuar afat plotesimi dokumentacioni 3 (tre) ditë punë, pra deri më datën **15.04.2022**.

3. Brenda datës **21.04.2022**, Komisioni shpall në këndin e njoftimeve të IPAP tabelat e pikëve totale e secilit kandidat sipas shtojcës nr. 6 , bashkelidhur këtij udhezimi.

4. Afatet e ankimit nga kandidatet për komisioni janë deri më datë **27.04.2022**. Brenda datës **28.04.2022**, Komisioni duhet ti kthej përgjigje ankimesve.

Kryetari i Komisionit dorëzon Drejtorit të ZVAP dosjet për dy kandidatet me më shumë pike.

6. Drejtori i ZVAP, pas shqyrtimit të dokumentacionit në ZVAP-in përkatës, përcjell dokumentacionin për dy kandidatët me më shumë pikë në DRAP brenda dates **04.05.2022**.
7. Drejtori i DRAP brenda datës **11.05.2022**, interviston dy kandidatët brenda datës **17.05.2022**, shpall vendimin për kandidatin fitues për pozicioni e drejtorit të IPAP.
8. Kandidati jofitues ka të drejtën e ankimit në MAS brenda 3(tre) ditë punë nga shpallja e kandidatit fitues.
9. MAS brenda 10 ditëve pune kthen përgjigje ankesës.

Në përfundim të të gjithë fazave të mësipërmë Drejtor i DRAP, bën emërimin e drejtorit të IPAP.

Pas vlerësimit të dosjeve aplikantët me dokumentacionin e plotë dhe të saktë do të kryejnë intervistën e strukturuar për:

Fusha e njohurive dhe aftësitë në drejtimin e institucionit mbi të cilat do të zhvillohet intervista e strukturuar:

- a) Ligji 69/2012 “Për arsimin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,
- b) Strategjia Kombëtare e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar 2021-2026.
- c) Urdhër nr.31, datë 19.01.2020 “Për miratimin e Rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore të arsimit parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”.
- d) Udhëzim nr.12, datë 10.06.2021 “Për procedurat e pranimit të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”.
- e) Udhëzimi nr.30, datë 12.09.2018 “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar”.

- f) Udhëzimi nr.2, datë 28.01.2020 "Për procedurat e emërimit, uljes në detyrë, pezullimit dhe të shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar", i ndryshuar.
- g) Udhëzimi nr.3, datë 09.02.2022 "Për procedurat e emërimit, uljes në detyrë, pezullimit dhe shkarkimit të nëndrejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar".
- h) Ligji nr.9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike".
- i) Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë.
- j) Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.

Bashkëlidhur lista me vendet vakante për cdo ZVAP

DREJTOR
Ana DHAMO



GRAFIKU I KONKURSEVE PER DREJTOR TE IPAP

FAZA E PARE

23.03.2022-01.06.2022.

NR.	DRAP	ZVAP	INSTITUCIONI ARSIMOR
1	DURRES	KAMEZ	SHKOLLA 9-VJECARE ARBERIA
2	DURRES	KAMEZ	SHKOLLA 9-VJECARE "JASHAR HOXHA"
3	DURRES	KAMEZ	SHKOLLA 9-VJECARE LIDHJA E PRIZRENIT
4	DURRES	KAMEZ	SHKOLLA 9-VJECARE AZEM HAJDARI PASKUQAN
5	DURRES	VORE	SHKOLLE 9 VJECARE AHMATAQ
6	DURRES	VORE	GJIMNAZI ISA BOLETINI VORE
7	DURRËS	KAVAJË	SHKOLLA 9-VJ."3 DËSHMORËT"
8	DURRËS	KAVAJË	SHKOLLA 9-VJ. GOLEM
9	DURRËS	KAVAJË	SHKOLLA 9-VJ. "HERBERT"
10	DURRËS	KAVAJË	SHKOLLA 9-VJ. BAGO
11	DURRËS	BULQIZË	ELEZ KOÇI
12	DURRËS	BULQIZË	ASLLAN KETA
13	DURRËS	BULQIZË	ISMAIL JANGULLI
14	DURRËS	BULQIZË	GJORICË E SIPËRME
15	DURRES	KRUJE	MYRTEZA MUSTAFA KAÇAÇI
16	DURRES	KRUJE	MYRTEZA HAMID PENGILI
17	DURRES	KRUJE	HAJDAR HOXHA
18	DURRES	KRUJE	GJERGJ KASTRIOT SKENDERBEU
19	DURRES	DURRES	FSHAT RINIA
20	DURRES	DURRES	HAJDAR DUSHI
21	DURRES	DURRES	OLSI LASKO PART TIME
22	DURRES	DURRES	SHKOLLA E RE

23	DURRËS	TIRANË	HASAN PRISHTINA
24	DURRËS	TIRANË	A.Z.ÇAJUPI
25	DURRËS	TIRANË	SHYQYRI PEZA
26	DURRËS	TIRANË	KONGRESI I MANASTIRIT
27	DURRËS	TIRANË	MYSLYM KETA
28	DURRËS	TIRANË	KOLE JAKOVA
29	DURRËS	TIRANË	LUIGJ GURAKUQI
30	DURRËS	RROGOZHINË	SHMB GOSE
31	DURRËS	KLOS	SHKOLLA 9VJECARE "RAMIZ KADIU"
32	DURRËS	KLOS	SHMB XIBËR
33	DURRES	DIBËR	9-VJEÇARE "HAKIK XHIKA"
34	DURRËS	DIBËR	9-VJEÇARE "HASAN LEKA"
35	DURRES	DIBËR	9-VJECARE" SOHODOLL"
36	DURRES	DIBËR	KATUND I RI
37	DURRES	DIBËR	BLLICE
38	DURRES	DIBER	AJET NDREU